

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Bekim Sejdiu tërhiqet nga kandidatura për president
ADRESA	https://www.koha.net/arberi/bekim-sejdiu-terhiqet-nga-kandidatura-per-president
BURIMI	koha.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 01:37:26 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 16:43:08 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	04fed50cdd1963fd5707f9aff0de953b003a043e5abf0d911f89786d3872e7a0
TEKSTI	5c387ec5b69a1420c6ec7c0d00b3aee741305dbf34673c77d5e855661a97526d
PAMJA	cf18e6b970180bdd45c7e7d9f7f7729fdbef8b6ffdaac2b2dd2b37733189ed5

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	0751c74efdbe39ef3329db729216a94f697216844638f0c686b0629be0ae62b8
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	339a441950953cdd8a76a2c095ab2238d5bab62fcc252abcef1242a6a5fba2fb
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/0751c74efdbe39ef3329db729216a94f697216844638f0c686b0629be0ae62b8>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Mbështete KOHËN. Ruaje të vërtetën

Kontribuo →

Letër lexuesit

ARBËRI

Bekim Sejdiu tërhiqet nga kandidatura për president

4 o. më parë

VV-ja pas tërheqjes së Sejdiut: Ishte mundësia që çështja e presidentit të zgjidhej, por u bllokua sërish

5 o. n

Naga



Foto: Driton Paçarada

14 shtator 2026 18:43

Shpërndaje në:



Klikoni këtu nëse dëshironi
t'i lexoni lajmet e fundit dhe
të përzgjedhura në kanal
tonë zyrtar në Viber

Kandidati për president, profesori Bekim Sejdiu ka njoftuar se është tërhequr nga kandidatura për president të Kosovës.

Sejdiu në një postim në Facebook ka thënë se duke u marrë parasysh rrethanat, të karakterizuara nga mungesa e mbështetjes së nevojshme parlamentare për t'u zgjedhur e po ashtu nga devijimi i tërë procesit, ka vendosur të tërhiqet dhe se për këtë ka njoftuar edhe përfaqësuesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe ata të Lëvizjes Vetëvendosje.

Sejdiu ishte prezantuar si kandidat konsensual për president dy javë më parë, pas marrëveshjes së dakorduar mes VV-së dhe LDK-së.

Por, gjashtë deputetë nga 18 sa i ka LDK-ja deklaruan se nuk do të votojnë për Sejdiun.

“Në rrethanat e krijuara, të karakterizuara nga mungesa e mbështetjes së nevojshme parlamentare për zgjedhjen time si Presidentit dhe nga devijimi i tërë procesit në vorbullën e dinamikave dhe përplasjeve të brendshme politike, kam vendosur të tërhiqem nga kandidatura për President të Republikës së Kosovës. Për këtë vendim timin i kam njoftuar më herët përfaqësuesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe të Lëvizjes Vetëvendosje. Mbështetja e gjerë që më është ofruar këto ditë, nga kolegë, miq, personalitete publike e të shoqërisë civile dhe, në mënyrë të veçantë, nga mërgata shqiptare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, më ka bërë krenar për punën time në shërbim të Republikës së Kosovës”, ka shkruar Sejdiu në Facebook.

Sejdiu tha se dy javë më parë ishte kontaktuar nga përfaqësues të LDK-së, të cilët e kishin ftuar në takim të përbashkët me

Arbëri.

Mustafa: Jam takuar me Kurtin për ta diskutuar platformën time për zhblokimin institucional

Futboll.

Newcastle pëson debakël nga Leeds

Futboll.

Spektakël në Serie A, Interi fiton 5:3 ndaj Udineses

Futboll.

Kosova i luan 4 ndeshje brenda 16 ditësh grumbullim

Arbëri.

VV-ja pas tërheqjes së Sejdiut: Ishte mundësia që çështja e presidentit të zgjidhej, por u bllokua sërish

LAJMET E MBRËMJES.

Mbrojtja kërkon lirinë e Thaçit e katër të tjerëve në rastin për pengim të drejtësisë

delegacionet e kryesuar nga LDK-ja dhe VV-ja.

“Aty u njoftova se, pas një procesi shterues bisedimesh, këto dy parti kanë arritur pajtueshmëri që emri im të propozohet si kandidat jopartiak për President të Republikës së Kosovës. E konsideroj këtë si besim të madh ndaj meje si person dhe një vlerësim për kontributin tim në jetën institucionale të Republikës së Kosovës. Përfaqësuesve të këtyre dy partive ua shpreh mirënjohjen time më të thellë, që më kanë nderuar me një besim të tillë dhe për mbështetjen e tyre përgjatë këtij procesi”, tha Sejdiu.

Ai tha se ka besuar se partitë politike dhe deputetët do ta gjejnë forcën për t'i tejkaluar ndasitë, e për t'i dhënë vendit institucione stabile në këto kohë të vështira.

Sejdiu thotë se Kosova s'ka nevojë “për drama politike dhe thellim të polarizimit, por për maturi dhe bashkim në funksion të forcimit të shtetit”.

“Prandaj, me sinjeritetin më të madh shpresoj se partitë politike do të gjejnë rrugëdalje nga ky rreth vicioz, i cili, më shumë se çdo gjë tjetër, po e venitë shpresën e qytetarëve për një të ardhme prosperuese për ta dhe familjet e tyre. Republika e Kosovës është shtëpia jonë e përbashkët, e lindur nga ideale të pathyeshme dhe sakrifica sublime. Kosova qëndron mbi çdonjërin prej nesh, ndaj, së bashku, ia kemi borxh t'i shërbejmë me devotshmëri, gjithmonë, kurdo dhe pa asnjë kusht”, ka shkruar Sejdiu.



VV-ja pas tërheqjes së Sejdiut: Ishte mundësia që çështja e presidentit të zgjidhej, por u bllokua sërish

4 o. më parë / 14 sht 2026 22:24



Lëvizja Vetëvendosje ka shprehur keqardhje që profesori Bekim Sejdiu ka vendosur të tërhiqet nga kandidatura për president të Kosovës.

Vetëvendosja ka thënë se marrëveshja për të propozuar Sejdiun si kandidat konsensual u arrit pas bisedimeve politike dhe vullnetit për t'i dhënë Kosovës një zgjidhje.

“Fatkeqësisht, pas arritjes së marrëveshjes, një pjesë e deputetëve të LDK-së doli kundër kandidaturës së miratuar edhe nga partia e tyre. Ndërsa PDK-ja dhe Aleanca u deklaruan se nuk do të mermin pjesë në procesin e zgjedhjes së Presidentit. Kështu u krijuan rrethanat që e pamundësuan zgjedhjen e Presidentit në Kuvend. Në këto rrethana erdhi edhe vendimi i profesorit Sejdiu për t'u tërhequr”, është thënë nga Lëvizja Vetëvendosje.

Vetëvendosje ka falënderuar Sejdiun për gatishmërinë e tij.

“Kuvendi është vendi ku dallimet politike shprehen me votë.

Mund të votosh për, mund të votosh kundër. Por kur mospjesëmarrja përdoret për ta pamundësuar votimin, atëherë nuk kemi më dallim politik rreth një kandidati, por pengim të vetë procesit kushtetues dhe dërgimin e vendit në zgjedhje të përsëritura. E falënderojmë profesor Bekim Sejdiun për gatishmërinë për t'i shërbyer Republikës dhe për dinjitetin e treguar gjatë këtij procesi. Kosova e pati marrëveshjen dhe kandidatin e përbashkët. E pati mundësinë që çështja e Presidentit të zgjidhej në Kuvend. Por u bllokua, sërish", thuhet nga VV.

Sejdiu ishte propozuar kandidat konsensual dy javë më parë. Por, gjashtë deputetë të LDK-së u deklaruan se s'do të votojnë Sejdiun. Hykmete Bajrami, Avdullah Hoti, Kujtim Shala, Armend Zemaj, Arben Gashi dhe Janina Ymeri u deklaruan kundër kësaj kandidature.

**Lëvizja VETËVENDOSJE!**
rreth 2 javë më parë

Lëvizja VETËVENDOSJE! shpreh keqardhjen për tërheqjen e profesorit Bekim Sejdiu nga kandidatura për President të Republikës së Kosovës.

Bekim Sejdiu ishte kandidat i përbashkët, i dalë nga marrëveshja ndërmjet Lëvizjes VETËVENDOSJE! dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës. Marrëveshja u arrit pas bisedimeve politike dhe me vullnetin për t'i dhënë vendit një zgjidhje. Kandidatura e tij krijoi mundësinë që zgjedhja e Presidentit të përmbyllej në Kuvend dhe Kosova të mos hynte sërish...

Shiko më shumë

Nagavci: Tërheqja e Sejdiut nga gara për president është humbje

5 o. më parë / 14 sht 2026 21:25



Deputetja e Lëvizjes Vetëvendosje, Arbërie Nagavci, ka thënë se tërheqja e profesor Bekim Sejdiut nga kandidatura për president të Kosovës është humbje.

Nagavci ka shprehur mirënjohje për Sejdiun që ka treguar gatishmërinë për t'u kandiduar për president.

Sejdiu ishte propozuar si president konsensual në marrëveshjen e dakorduar mes Lëvizjes Vetëvendosje dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës, dy javë më parë. Por, ai sot ka njoftuar se është tërhequr nga gara.

Kundër Sejdiut ishin deklaruar gjashtë nga 18 deputetët e LDK-së. Kujtim Shala, Avdullah Hoti, Hykmete Bajrami, Arben Gashi, Armend Zemaj dhe Janina Ymeri deklaruan se nuk do ta votojnë Sejdiun.

Nagavci ka thënë se po krijohet një klimë politike që po demotivon personalitete që të vënë dijen e përvojën në shërbim të shtetit.

"Tërheqja e prof. dr. Bekim Sejdiut nga gara për President të Republikës është humbje për një proces që do të duhej të sillte në vëmendje personalitete me integritet, profesionalizëm dhe kredibilitet. Fatkeqësisht, në vend që të krijojmë hapësirë për personalitete të tilla që të vënë dijen dhe përvojën e tyre në shërbim të shtetit, po krijohet një klimë politike që i demotivon ata. Përpjekja për ta çuar vendin me lehtësi drejt zgjedhjeve të reja po na dërgon nga një bllokadë në tjetrën, duke e bërë gjithnjë e më të vështirë ndërtimin e një konsensusi që i duhet vendit. Kosova nuk ka nevojë për bllokada të reja. Ka nevojë për përgjegjësi, stabilitet institucional dhe gatishmëri për të gjetur zgjidhje. Prof. Sejdiu i shpreh respekt dhe mirënjohje për

gatishmërinë që, me integritetin dhe profesionalizmin e tij, t'i shërbejë Republikës", ka shkruar Nagavci në Facebook.



Abdixhiku: Bekim Sejdiu tregoi dinjitet

7 o. më parë / 14 sht 2026 19:12



Photo: Driton Paçarada

Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka reaguar pas vendimit të Bekim Sejdiu për tërheqje nga kandidatura. Abdixhiku është shprehur se Sejdiu ka treguar dinjitet dhe se tërheqja e tij dëshmon pse ishte zgjedhja e duhur për këtë pozitë.

Abdixhiku ka thënë se kjo është PISA politike e Kosovës, duke rrënuar çdo përpjekje normale.

Gjashtë deputetë të këtij subjekti politik u deklaruan kundër kandidaturës së Sejdiu.

"Sa shumë kemi nevojë për njerëz të mirë në këtë vend. Sa lehtë i hedhim poshtë. Kjo është PISA politike e Kosovës. Me rëndësi të rrenojmë çdo përpjekje normale sot! Bllkohemi, ngecim, urrejmë, mbysim karaktere dhe përfundojmë sërish në zgjedhje. Edhe pas tyre, në te tjerat", ka shkruar mes tjerash Abdixhiku.



Edhe ish-presidentja e vendit Vjosa Osmani, njëherit përfaqësuesja e LDK-së në negociatat me Lëvizjen e Vetëvendosje për çështjen e presidentit, ka thënë se Sejdiu duhet të falënderohet jo vetëm për gatishmërinë për t'i shërbyer vendit por edhe për mënyrën se si e përballoi tërë këtë proces.

"Jo vetëm për gatishmërinë për t'i shërbyer vendit, por edhe për mënyrën se si e përballoi një proces ku personalja shpesh u vendos mbi institucionalen. Ndoshta pikërisht këtu qëndron humbja jonë më e madhe: jo vetëm që nuk arritëm të zgjedhim Presidentin, por humbëm edhe një tjetër mundësi për të treguar se në Kosovë mund të ndërtojmë konsensus rreth njerëzve me dije, integritet dhe dinjitet", ka shkruar Osmani në Facebook.





Bekim Sejdiu meriton falënderim.

Jo vetëm për gatishmërinë për t'i shërbyer vendit, por edhe për mënyrën se si e përballoi një proces ku personalja shpesh u vendos mbi institucionalen.

Ndoshta pikërisht këtu qëndron humbja jonë më e madhe: jo vetëm që nuk arritëm të zgjedhim Presidentin, por humbëm

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.